



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM
Nr. 8 datë 26.2.2020**

**PËR
DHËNIE PËLQIMI PËR DHËNIE ME QIRA TË ZYRAVE TË SHËRBBIMIT NË
GODINAT E NJËSIVE ADMINISTRATIVE, ANA E MALIT, DAJÇ,
BËRDICË, VELIPOJE DHE RRETHINA”, NE PRONËSI/ADMINISTRIM TË
BASHKISË SHKODËR, NË FAVOR TË DREJTORISË RAJONALE TË
SIGURIMEVE SHOQËRORE SHKODËR.**

Këshilli Bashkiak Shkoder, në mbledhjen e datës 26. 2. 2020, me propozim të Kryetarit të Bashkisë mbështetur në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1.2, neni 36 germa ‘a’, neni 54 germa “e/1” të ligjit nr.139/2015 “Për veteqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr.115, date 31.07.2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” I ndryshuar, ligjit nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” I ndryshuar, ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” të ndryshuar, VKM-së nr.510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara dhe të patrupëzuara, të arkivave dhe çdo dokumentacioni tjetër zyrtar në Njësitë e Qeverisjes Vendore të prekura nga riorganizimi Administrativo territorial”, VKM nr.54, datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfitozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” të ndryshuar, Udhëzimit nr.30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” të ndryshuar sipas Relacionit të administratës së bashkisë Shkoder, me 36 vota pro,

V E N D O S I:

1. Të jap pëlqimin për dhënie me qira të një zyre shërbimi, në ambjentet e Njesisë Administrative Ana e Malit, në pronësi të Bashkisë Shkodër me sipërfaqe 12 m2,

pjesë e pasurisë së paluajtshme nr.1128/13, në zonën kadastrale nr.2817, fshati Oblike e Madhe, njësia administrative **Ana e Malit**, Bashkia Shkodër, sipas Gen Planit bashkëlidhur.

2. Të jap pëlqimin për dhënie me qira të një zyre shërbimi, në ambjentet e Njesisë Administrative Dajç, në pronësi të Bashkisë Shkodër me sipërfaqe 11 m², pjesë e pasurisë së paluajtshme nr.1248/3 ,në zonën kadastrale nr.1435, fshati Dajç, njësia administrative **Dajç**, Bashkia Shkodër, sipas Gen Planit bashkëlidhur.
3. Të jap pëlqimin për dhënie me qira të një zyre shërbimi, në ambjentet e Njesisë Administrative Bërdicë, në pronësi të Bashkisë Shkodër me sipërfaqe 14.8 m² pjesë e pasurisë së paluajtshme nr.30/24, në zonën kadastrale nr.1159, fshati Berdice e Siperme, njësia administrative **Bërdicë**, Bashkia Shkodër, sipas Gen Planit bashkëlidhur.
4. Të jap pëlqimin për dhënie me qira të një zyre shërbimi, në ambjentet e Njesisë Administrative Velipoje, pronë në administrim të Bashkisë Shkodër me sipërfaqe 14.65 m² pjesë e pasurisë së paluajtshme nr.458/2, në zonën kadastrale nr.1799, fshati Gomsiqe e Re, njësia administrative **Velipojë**, Bashkia Shkodër, sipas Gen Planit bashkëlidhur.
5. Të jap pëlqimin për dhënie me qira të një zyre shërbimi, në ambjentet e Njesisë Administrative Rrethina, në pronësi të Bashkisë Shkodër me sipërfaqe 2.25m² pjesë e pasurisë së paluajtshme nr.106/5, në zonën kadastrale nr.1790, fshati Golem, njësia administrative **Rrethina**, Bashkia Shkodër, sipas Gen Planit bashkëlidhur.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
7. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit


Denis Lesha

KRYETARE

